



## **PROCESVERBALI**

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: 16.06.2023 me fillim në ora 10:10. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zt. Bajram Morina.

Kryesuesi – Fillimi i përshtetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj. Përshtetje për përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, zëvendëskryesuesin, përshtetje për anëtarët dhe gjithë të pranishmit. Ky është takimi i katërt për vitin 2023, për takimin e sotëm i kemi këto pikat që rendit të ditës:

## REND DITE

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
  2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike rrëth projekteve të dedikuara për komunitetin joshumicë;
  3. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rrëth mbështetjes me subvencione fermerëve dhe bujqeve nga komuniteti joshumicë;
  4. Të ndryshme.

### **1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** – A ka dikush ndonjë vërejtje për procesverbalin nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë unanime aprovohet procesverbal i mbledhjes së kaluar.

2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike rrëth projekteve të dedikuara për komunitetin joshumicë;
  3. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rrëth mbështetjes me subvencione fermerëve dhe bujqeve nga komuniteti joshumicë;

**Kryesuesi – Pika e dytë dhe e tretë me arsyen shtyhen përmblledhjen e radhës. Drejtori i Shërbimeve publike është në takim jashtë vendit (në Japoni) dhe pika e tretë, gjithashtu drejtori Duraku është përmblledhja e tretë.**

#### **4. Të ndryshme;**

**Dusan Stojanovic** – Fillimi shqiptar përfshin një kërkim të gjithë anëtarët e KK-së. I kam disa kërkesa sa i përket komunitetit joshumicë të lagjes së epërme. Kërkesa e parë ka të bëjë me komunitetin që jetojnë në Hoçë të Madhe, ata kërkojnë ta dinë çështjen e pastrimit të kanalit të lumbit i cili rrjedh në fshat, çka është puna e këtij projekti?... E dyta, është poashtu për komunitetin e fshatit Hoçë e Madhe që ka të bëjë me ekoregjonin për çështjen e vendosjes së kontejnerëve, kur do të vendosen kontejnerët?... E treta, ka të bëjë me çështjen e vendosjes së disa pengesave në rrugë (police të shtrirë), kohë më parë e kemi bërë një kërkesë dhe kemi hasur në keqkuptim sepse ata kanë menduar që ne po kërkojmë vetëm një pengesë, përderisa ne i kemi kërkuar shtatë pengesa. Kërkojmë zgjidhjen e këtij problemi!

**Ramë Berisha** – Përvendetje për pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit e KFOR-it. I kam dy pikat për raportim në këtë mbledhje. Fjala është për Shërbimet Publike, për projektet e infrastrukturës. Në një lagje të Xërës, në rrugën “Elena Gjika” nuk ka anësore të këmbësorëve (trotuarë) qe disa vite. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare, zyrtarisht nëpër institucione gjuha e popullatës joshumicë duhet të respektohet dhe zbatohet.

**Edonë Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë!** Të nderuar të pranishëm në këtë seancë, ju kërkoj falje për vonesën. Ne si asambleistë të këtij komiteti kemi rol të veçantë brenda seancës sepse këtu jemi për adresimin e brengave dhe haleve të qytetarëve, saktësish për komunitetin joshumicë. Por, si mund t'i adresojmë brengat tona kur takimet tona nuk mbahet ose organizohen një herë në dy muaj. Nuk e dimë pse kemi kaq pak takime, kur ligji e lejon një gjë të tillë e të mbahen më shumë. Propozoj që në emër timin personal dhe të kolegut Faton Ramadani, që takimet tona të janë së paku një herë në muaj.

**Faton Ramadani - Faleminderit** kryesues, përshëndetje për të gjithë. Pika e dytë: Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike rreth projekteve të dedikuara për komunitetin joshumicë dhe e treta: Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth mbështetjes me subvencione fermerëve dhe bujqeve nga komuniteti joshumicë, përfaqësuesit që kanë për t'i diskutuar këto dy pika, po shihet që nuk janë këtu dhe këto dy pika të a shtyhen për një seancë tjeter?

**Kryesuesi – Faleminderit** zt. Faton, te pika e dytë e drejtorisë së Shërbimeve publike, kemi informatë që drejtori është jashtë vendit në udhëtim dhe gjithashtu pika që është e drejtorisë së Bujqësisë, drejtori është në terren. Pikat në fjalë kalojnë për në takimin e radhës.

**Faton Ramadani –** Është e sata herë që drejtoritë nuk i përgjigjen ftesave tona që i ftojmë të marrim pjesë në mbledhje dhe mendoj që këtë komitet nuk e trajtojnë ashtu siç e ka rëndësinë.

**Kryesuesi – Faleminderit!** Ne çdo herë iu dërgojmë ftesë zyrtare dhe problemi nuk qëndron te ne. Besoj që në takimet e radhës do të janë pranishëm. Sa i përket pyetjes së anëtares Edonë: Kam qenë në zyrën ligjore përkonsultë dhe sipas ligjit lejohen të mbahen edhe gjashtë takime në vit (së paku 6 takime).

**Faton Ramadani –** Sa i përket kësaj çështjeje, ne e diskutuam edhe në trajnim te restorant natyra, trajnim i organizuar nga organizatat e huaja. Aty patëm përfaqësues nga Komiteti për Komunitet të qyteteve regionale (Malishevë, Suharekë, Prizren) dhe u fol me kritika ndaj numrit të vogël të seancave të mbajtura në Komunën e Rahovecit. Kryesuesi i Prizrenit tha që së paku një herë në muaj e mbajmë një seancë. Ligji është i barabartë për të gjithë.

**Kryesuesi –** Do ta shqyrtoj dhe diskutoj edhe një herë me zyrën ligjore rrjedhën e takimeve dhe do të informohemi me kohë. Nëse edhe dikush ka diçka për diskutim?... Nëse jo, atëherë konstatoj që takimi i sotëm përfundoi, faleminderit dhe shihemi në takimin e radhës.

Procesmbarhjtësi;



Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;



Bajram Morina

